

e tyre për një javë. Ditën e premte, më **17.07.1998**, erdhën në punë vetëm për t'i qerosur kolegët në kombinat për shkak të gëzimit familjar. Rreth orës 14:30, u nisën për në qytet. Në afërsi të pikës së karburanteve *Jaha Petrol*, ata u ndalën nga ushtarët e UÇK-së. I nxorën babanë dhe të birin nga makina dhe i çuan në pronën e një ushtari të UÇK-së [identiteti i tij është i njohur për FDH], dhe, më pas, në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Në datën 26.07.1998, ata që të dy dhe të gjithë të burgosurit e tjerë, që kishin mbetur në burg, u futën në një autobus me xhama të mbyllur dhe u dërguan në drejtim të Prishtinës/Priština. Pas afro gjysmë orë vozitjeje, autobusi u prish dhe të burgosurit u transferuan në një kamion. Pas pak, arritën në një fshat të panjohur. Ushtarët i nxorën nga autobusi Azemin, Visarin, familjen Baljošević [Krunoslava dhe Snežana me foshnje] dhe Lukić [bashkëshortja dhe vajza e Jovan Lukićit] dhe tre shqiptarë. I vendosën në një ahur. Në mëngjesin tjetër, më 27.07.1998, ushtarët i çuan Azemin, Visarin dhe tre shqiptarë në drejtim të panjohur. Mbetjet mortore të Azemit dhe Visarit janë zbuluar në Varrezat e Dragodanit në Prishtinë/Priština. Familjarët i kanë varrosur mbetjet e tyre mortore në Rahovec/Orahovac, më 19.11.2005.

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata N.G, FDH-465; deklarata S.B, FDH-5513; deklarata A.I, FDH-5517; deklarata V.M, FDH-5693; deklarata H.A, FDH-12269; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, XVII, 310; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; AIS, *Zona...*, 66, FDH-16913; AFRZZHKEM, *Regjistri i personave...*, FDH-16116.

Srdan (Arsenije) Vitošević

(29.11.1972, serb nga Rahoveci/Orahovac, nëpunës, një fëmijë)

Srdani punonte si referent i Drejtorisë së të Ardhurave në komunën e Rahovecit/Orahovac. Ditën e premte [17.07.1998], Srdani dhe bashkëshortja e tij po përgatiteshin për të shkuar në deti. Srdani doli nga shtëpia rreth orës 18:30, me makinën e vet të tipit *Opel Kadet*, deri te

barnatorja pranë Shtëpisë së Shëndetit, për të blerë pelena për foshnjën. I kishte të veshur fanellën me mëngë të shkurtra, pantallona të shkurtra dhe papuçe. Ushtarët të UÇK-së e kanë ndaluar në vendin e papërcaktuar në qytet dhe e kanë çuar te vendi i quajtur *Koritë Uji/Pojilo*. Me pas, e çuan, së bashku me serbë dhe romë të tjerë, në burgun e Malishevës/Mališevo. Ishte i mbyllur në një dhomë me djalën e axhës Srećko, Dušan Patrnogić, Aleksandar Stanojević dhe Jovan Lukić. Në mbrëmjen e ditës tjetër, më 18.07.1998, pjesëtarët e UÇK-së i nxorën Srdanin dhe të burgosurit të tjerë nga dhoma. Ata ishin në kuadrin e grupit të parë, i cili u çua jashtë burgut të Malishevës/Mališevo dhe u zhduk në rrethana misterioze. Srdan konsiderohej i zhdukur nga KNKK-ja deri në vitin 2006, kur në lëndën e tij u vendos mbishkrimi *found dead (i gjetur i vdekur)*. Familjarët ende nuk dëshirojnë t'i pranojnë mbetjet e tij mortore, sepse besojnë se ai akoma është i gjallë.

Burimet: deklarata J.L, FDH-455; deklarata D.V, FDH-860; deklarata A.V, FDH-5518; deklarata S.S, FDH-5690; deklarata G.I, FDH-18940; deklarata O.V, FDH-30967; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; AIS, *Zona...*, 52, FDH-16913; *Nedopustiva briga i neodgovornost*, Oteta istina, num. 15, korrik-shtator 2008, 17-18, FDH-19947.

Agron (Gani) Hamza

(14.02.1968, ashkali nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, tre fëmijë)

Agroni punonte si korrier në ndërmarrjen *18 Nëntori* në Rahovec/Orahovac. Ditën e premte [17.07.1998], u kthye nga puna rreth orës 14:00. Pas përfundimit të drekës, shkoi me familjarët për një vizitë te motra Hajrije. Kur, nga ora 17.00, në qytet u dëgjuan të shtëna të para, Agroni me familjarë u nisën në shtëpi. Në udhëkryq, i cili gjendet në hyrje të lagjes ku banonte Agroni [**Rahovec/Orahovac**], u ndalën nga katër burra të armatosur dhe të veshur me rroba civile, që flisnin shqip. Filluan ta qëllonin Agronin me grushte dhe kondakë. Pastaj e morën me vete, ndërkaq të tjerëve u